



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT NË FUSHËN E
MINIERAVE DHE INDUSTRIË**

Nr. 10039/ prot.

Tiranë, më 08. 4.2018

Lënda: Njoftim për fillim procedurash revokimi të lejes nr.1624, datë 03.04.2013.

**SHOQËRISË “SALILLARI” SH.P.K
Ura Vajgurore, Berat.**

**Për dijeni: AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE
Bulevardi “Bajram Curri”, Blloku “Vasil Shanto”, Tiranë.**

**AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE
EMERGJENCAT NË MINIERA
Rruga “Lord Bajron”, Laprakë, Tiranë.**

Shoqëria “Salillari” sh.p.k është zotëruese e lejes minerare të shfrytëzimit nr.1624, datë 03.04.2013, për mineral gur gëlqeror, në objektin “Krrabë e Vogël”, Tiranë.

Nga struktura përgjegjëse e AKBN-së me shkresën nr.6433 prot., datë 18.07.2018, protokolluar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) me nr.10039 prot., datë 18.07.2018, është propozuar revokimi i lejes minerare të shfrytëzimit nr.1624, datë 03.04.2013, për mineral gur gëlqeror, në objektin “Krrabë e Vogël”, Tiranë, për arsye nuk është paguar nga shoqëria juaj, vlera e garancisë së rehabilitimit të mjedisit për vitin 2016-2017, siç është përcaktuar në germën “ç”, të nenit 25 dhe në pikën nr.3, të nenit 31, të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore për revokim, është i mbështetur në germën “ç”, të pikës 1, të nenit 47, (neni që përcakton shkeljet ligjore për të cilat një leje revokohet) të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Sa më sipër, në zbatim të nenit 48, të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, **ju njoftojmë fillimin e procedurave të revokimit të lejes minerare të nr.1624, datë 03.04.2013, për mineral gur gëlqeror, në objektin “Krrabë e Vogël”, Tiranë, që shoqëria juaj zotëron.**

Ju bëjmë me dije se, pas një periudhe 30 ditore nga ky njoftim, do të merret vendimi për revokimin e lejes nr.1624, datë 03.04.2013, për mineral gur gëlqeror, në objektin “Krrabë e Vogël”, Tiranë.

Në zbatim të nenit 49, të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, duhet të rehabilitoni zonën e shfrytëzimit në të cilën keni ushtruar aktivitet minerar.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin.

MINISTRI
DAMIAN GJIKNURI
ME AUTORIZIM
ZËVENDËSMINISTRI
ENIS ALIKO

